







EKONOMIA SOCIALE *dhe* SOLIDARE

Ekonomi me ndikim!





EKONOMIA SOCIALE *dhe* SOLIDARE

Parimet dhe Vlerat



Njerëzit & Planeti mbi Fitimin

përparësia e njerëzve si dhe e qëllimit social dhe/ose mjedisor mbi motivin e fitimit.



Riinvestimi për të mirën e përbashkët

riinvestimi i pjesës më të
madhe të fitimeve dhe
suficitit për të kryer
aktivitete në interes të
anëtarëve/përdoruesve
("interesi kolektiv") ose të
shoqërisë në tërësi
("interesi i përgjithshëm").



Qeverisja Demokratike

bazuar në qeverisjen
demokratike dhe/ose
pjesëmarrëse, ku të
gjithë kanë zë.



Vlerat Thelbësore

-  Solidariteti;
-  Bashkëpunimi vullnetar & ndihma e ndërsjellë;
-  Barazia dhe drejtësia;
-  Autonomia;
-  Ndërvarësia;
-  Transparenca;
-  Llogaridhënia;
-  Vetëqeverisja.

#Ekonomimendikim

Bashkëfinancuar
nga Bashkimi European



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM




ÇFARË ËSHTË EKONOMIA SOCIALE *dhe* SOLIDARE?



Ekonomia Sociale & Solidare

i referohet formave të aktiviteteve dhe marrëdhënieve ekonomike (si kooperativat, shoqatat, fondacionet, shoqëritë e bashkëpunimit reciprok, dhe sipërmarrjet sociale) që i japin përparësi objektivave sociale dhe mjedisore mbi maksimizimin e fitimit.



Në Shqipëri

pavarësisht se ekzistojnë
forma të ndryshme të SSE,
nuk ka një përkufizim ligjor
apo zyrtarisht të përcaktuar
të **Ekonomisë Sociale dhe
Solidare**, një mungesë që
kërkon vëmendje dhe
ndryshim.



FORMAT ORGANIZATIVE TË EKONOMISË SOCIALE *dhe* SOLIDARE?



Kooperativat

(Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor)

janë shoqata autonome personash që bashkohen për të përmbushur qëllime të përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Kooperativat i arrijnë objektivat e tyre përmes krijimit të sipërmarrjeve të drejtuara në mënyrë demokratike.



Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok

janë iniciativa që ofrojnë shërbime të sigurimit të jetës dhe të tjera, skema plotësuese të sigurisë sociale dhe shërbime me vlerë me natyrë sociale.

Qëllimi i tyre kryesor është të plotësojnë nevoja të përbashkëta dhe jo të gjenerojnë fitim apo të sigurojnë kthim kapitali. Ato menaxhohen sipas parimeve të solidaritetit midis anëtarëve, të cilët marrin pjesë në qeverisjen e tyre.



Shoqatat & Fondacionet

Shoqatat janë entitete ligjore jofitimprurëse të bazuara në modelin e anëtarësimit, të cilat mund të kryejnë veprimtari ekonomike me kushtin që të mos shpërndajnë fitim te anëtarët e tyre. Shoqatat mund t'i shërbejnë një sërë qëllimesh, përfshirë qëllime kolektive, sociale dhe në dobi të publikut.

Fondacionet janë entitete ligjore jofitimprurëse që mbështesin aktivitete filantropike dhe jo vetëm, me qëllim të shërbimit për të mirën e përbashkët. Fondacionet krijohen shpesh me fonde të dedikuara, para të dhëna nga individë, familje ose korporata.



Sipërmarrjet Sociale

janë entitete që funksionojnë duke ofruar mallra dhe shërbime në treg në një mënyrë sipërmarrëse dhe shpesh inovative, në përputhje me parimet dhe karakteristikat e ekonomisë sociale, duke pasur objektiva sociale dhe/ose mjedisore si arsye kryesore të veprimtarisë së tyre tregtare.

Sipërmarrjet sociale marrin një sërë formash ligjore, në varësi të kontekstit kombëtar.



#Ekonomimendikim



DALLIMET MIDIS EKONOMISË SOCIALE EKONOMISË SOLIDARE SSE

dhe

SIPËRMARRJES SOCIALE



Ekonomia Sociale (SE)

është një koncept i përhapur gjerësisht, veçanërisht në Evropë, dhe i referohet formave të caktuara organizative që funksionojnë me një qëllim social.

Përsa i përket formave ligjore të veprimit: këtu përfshihen kooperativat, shoqëritë e bashkëpunimit reciprok, shoqatat, fondacionet dhe sipërmarrjet sociale.



Ekonomia Solidare

është më shumë një lëvizje sociale dhe një filozofi veprimi. Ajo thekson praktikat e bazuara në komunitet, bashkëpunimin e ndërsjellë dhe veprimin e drejtpërdrejtë për të krijuar një alternativë ndaj ekonomisë tradicionale.

Kopshte komunitare, rrjete të tregtisë së drejtë (fair trade), banka kohe (time bank) dhe nisma të bazuara në komunitet, të gjitha të udhëhequra dhe mbështetura në vlera dhe praktika që promovojnë solidaritet dhe pjesëmarrje.


Bankë Kohe (Time Bank)*: janë sisteme komunitare ku njerëzit shkëmbejnë shërbime duke përdorur kohën si monedhë, në vend të parave.



Ekonomia Sociale & Solidare

Ekonomia Sociale dhe Solidare përfaqëson fushën më të gjerë që përfshin si format organizative të Ekonomisë Sociale, ashtu edhe lëvizjet me bazë komunitare dhe vlerat e Ekonomisë Solidare.

Është një koncept gjithëpërfshirës i përdorur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).



Sipërmarrje Sociale

është një lloj sipërmarrje/biznesi që operon brenda Ekonomisë Sociale dhe Solidare. Është një sipërmarrje që përdor strategji të orientuara drejt tregut për të arritur një mision kryesor social ose mjedisor. Fitimet riinvestohen në shërbim të këtij misioni.

Mund të funksionojnë dhe operojnë në forma të ndryshme si: kooperativa, organizata jofitimprurëse, ose fitimprurëse (bizneset) me një qëllim social.





PSE ËSHTË E RËNDËSISHME EKONOMIA SOCIALE

dhe

SOLIDARE (SSE)?



Ekonomia Sociale & Solidare


na ndihmon të ndërtojmë një ekonomi që funksionon për të gjithë.




Krijon vende pune të denja & kushte të mira pune



Fuqizon grupet vulnerabël dhe të nën-përfaqësuar



Forcon komunitetet lokale dhe nxit zhvillimin lokal



Mbron mjedisin përmes praktikave të qëndrueshme



Promovon drejtësinë, transparencën & pjesëmarrjen demokratike



Ndërton mirëqenie komunitare, përfshirje sociale & qëndrueshmëri afatgjatë



ZHVILLIMI I SSE NË SHQIPËRI



Ekonomia Sociale & Solidare

në Shqipëri është ende duke u zhvilluar, por megjithatë ajo tashmë ka një kontribut të madh në krijimin e impaktit social pozitiv edhe në fuqizimin e komuniteteve.

Edhe pse SSE nuk njihet ende zyrtarisht si një sektor i veçantë në Shqipëri, forma të saj si **sipërmarrjet sociale, kooperativat, shoqatat, fondacionet, dhe iniciativat komunitare** ekzistojnë dhe kontribuojnë aktivisht në përfshirjen sociale dhe zhvillimin lokal.



Çfarë mungon?

Sot, kuadri ligjor dhe politik mbetet i kufizuar.

Edhe pse ekziston një ligj për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë, ai reflekton vetëm një pjesë të realitetit dhe nuk përfaqëson plotësisht diversitetin dhe potencialin e sipërmarrjeve sociale në Shqipëri.



Çfarë duhet për të ardhmen?

Kjo fushatë është vetëm një hap i një pune më të madhe. **Partnerët Shqipëri** mbetet e angazhuar për të mbështetur zhvillimin e *Ekonomisë Sociale dhe Solidare*, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar njohje më të madhe të impaktit të tyre.

Qëllimi kryesor është të sigurohet njohja institucionale dhe politika që ofrojnë mbështetje afatgjatë, duke vendosur SSE aty ku i takon: *në zemër të zhvillimit social dhe ekonomik të Shqipërisë.*

